VENDIM
Nr. 640, datë 1.10.2014

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH BUXHETORE BRENDA PROGRAMEVE TË MIRATUARA NË BUXHETIN E VITIT 2014 PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 17, të ligjit nr. 185/2013, "Për buxhetin e vitit 2014", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2014, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, bëhet rishpërndarja e fondeve, si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor 07220, "Shërbimet e kujdesit parësor", në artikullin 604, "Të tjera transferime korrente të brendshme", të pakësohet fondi prej 350 000 000 (treqind e pesëdhjetë milionë) lekësh.

b) Në programin buxhetor 07330, "Shërbimet e kujdesit dytësor", në artikullin 604, "Të tjera transferime korrente të brendshme", të shtohet fondi prej 350 000 000 (treqind e pesëdhjetë milionë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama